

VENDIM
Nr. 849, datë 6.12.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 23.4.2011 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9 e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet, si më poshtë vijon:

“9. Përfundimisht për vitin 2012, fondi i veçantë nuk përdoret për shpërblimin e punonjësve për rezultate të mira në punë, për shpërblime të parashikuara me akte të tjera, ligjore apo nënligjore, për dhënie ndihmash të menjëhershme në raste fatkeqësish dhe në raste të tjera, si dhe për veprimtari social-kulturore.”.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha